

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Auditim
(zgjidhjet)**

P6

Data 21 janar 2017

Detyra 1

Jeni duke planifikuar auditimin e Drunaja Shpk për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016. Kompania prodhon dhe shet produkte nga druri i importuar. Në vitet e fundit, kompania ka zgjeruar produktet me prodhimin e elementeve të kopshtit për fëmijë të cilat shiten me një garancion prej 10 vitesh. Shumica e shitjeve u bëhen blerësve vendor por gjithashtu kompania ka një treg të vogël të eksportit që është rritur në mënyrë stabile në vitet e fundit.

Në takimin e planifikimit të auditimit me drejtorin financiar, janë diskutuar çështjet në vijim:

Aktivitetet operative

Gjatë vitit, të hyrat e kompanisë janë rritur për 20% dhe marzha bruto dhe operative janë rritur për 5% dhe 2% përkatësisht. Saldot e stoqeve dhe llogarive të arkëtueshme janë dukshëm më të larta krahasuar me vitin e mëparshëm si rezultat i rritjes së aktivitetit. Porositë e produkteve përmes faqes së internetit të kompanisë kanë filluar në janar 2015. Porositë përmes internetit janë rritur në mënyrë stabile por ende paraqesin një përqindje të vogël të shitjeve totale të kompanisë. Mirëpo, kompania vazhdon të investojë në faqen e internetit për të mbajtur shpejtësinë dhe lehtësinë e përdorimit të saj nga konsumatorët.

Pagat

Pas implementimit të suksesshëm të sistemit të ri të kompjuterizuar para dy vitesh, procesimi i pagave, i cili më herët ishte kontraktuar nga një kompani tjetër, tani përsëri bëhet nga vet kompania nga 1 mars 2016. Menaxhmenti nuk ishte i kënaqur nga shërbimet e ofruara nga kontraktori i jashtëm i procesimit të pagave prandaj kishte anuluar kontratën. Nga kompania janë punësuar personel shtesë për të procesuar pagat.

Drejtori menaxhues (DM)

DM ka paralajmëruar se synon të shes tërë pronësinë (aksionet) e tij në Drunaja sepse dëshiron të koncentrohet në interesa në biznese tjera. Negociatat tashmë janë duku u zhvilluar më një blerës të mundshëm të aksioneve të tij.

Kërkohet:

- (a) Duke përdorur informatat e dhëna, diskutoni rreziqet kyçe të auditimit dhe rekomandoni përgjigjet e duhurat të auditimit për secilin rrezik në fazën e planifikimit të auditimit në Drunaja. (10 pikë)
- (b) Shpjegoni procedurat thelbësore (pavarura) të cilat duhet të kryhen nga auditori për të konfirmuar saktësinë dhe plotësinë e shpenzimit të pagave të Drunaja. (6 pikë)
- (c) Diskutoni shkurt çka nënkutpohet me rrotacionin në auditim dhe shpjegoni përparësitë dhe pengesat e saj. (4 pikë)

Total: 20 Pikë

Zgjidhja

(a) Rreziqet e auditimit

Rreziku

Faturat nga importet kanë gjasë të jenë më valutë të huaj. Kjo e rritë rrezikun e përkthimit të gabuar të valutës së huaj në valutën vendore. Ka rrezik të anomalisë në blerje dhe të pagueshme.

Të gjitha pajisjet shiten më një garancion prej 10 vitesh. Drejtorët duhet të vlerësojnë kostot e mundshme të riparimit për pajisjet që dëmtohen. Ky vlerësim ndonjëherë është i vështirë për tu bërë. Ka rrezik të anomalisë në provizionimin e kostos së garancisë.

Rritja në të hyra së bashku me marzhën e fitimit bruto nuk mund të paraqes faktor për dyshim. Mirëpo shitja e 100% aksioneve të DM paraqet një arsye domethënëse që kompania dëshiron të manipulojë fitimin për të fituar sa më shumë nga shitja e aksioneve. Ka rrezik që fitimi i vitit të përmbajë anomali.

Drunaja vazhdon të investoj në faqen e internetit për të përmirësuar përdorimin e saj. Çfardo kosto pasuese duhet të njihet si shpenzim dhe të mos kapitalizohet. Vetëm kostot që rrisin përfitimin e një pasurie joqarkulluese mund të kapitalizohen. Ka rrezik të anomalisë në koston e mirëmbajtjes së faqes së internetit

Sistemi i ri i pagave është operativ vetëm 9 muaj dhe stafi i cili e administron këtë sistem

Përgjigja e auditorit

Për një mostër të blerjeve përputhni normën e këmbimit të aplikuar me burim të jashtëm, psh normat nga banka qendrore për të konfirmuar saktësinë e këmbimit.

Konfirmoni në softueri i kontabilitetit ka afësinë të trajtojë transaksionet në disa valuta duke testuar një mostër të regjistrimeve Pyetni menaxhmentin se si identifikojnë normat e sakta ditore të këmbimit. Për një mostër të të pagueshme materiale bëni ri-përkthimin e shumave që janë borxh me 31 dhjetor me normën e këmbimit në atë datë për të siguruar se shumat janë përthyer si duhet. Pyetni drejtorët si i vlerësojnë kostot e provizionit për garanci dhe kryeni rillogaritjen e tyre.

Krahasoni provizionin me parashikimin dhe me korrespondencat pas fundit të vitit me personat që pretendojnë për demtime të pajisjeve duke përcaktuar nëse provizioni aktual është i mjaftueshëm për të mbuluar kostot e riparimit.

Krahasoni provizionet e vitit të kaluar me nivelin e kthimit të mallrave këtë vit për të identifikuar saktësinë e vlerësimeve të vitit të kaluar.

Kryerja e procedurave analitike në të hyrat nga shitja. Përftimi i shpjegimeve të duhura nga menaxhmenti për rritjen e shitjeve për produkte. Kryerja e procedurës së prerjes për mallrat që janë dërguar para fundit të vitit dhe ato që janë dërguar pas fundit të vitit.

Ndjekja e këtyre mallrave në librin e shitjes dhe krahasimi nëse janë regjistruar në periudhën e duhur. Rishikimi i një mostre të notave të kreditit pas fundit të vitit për të identifikuar plotësinë e lejimeve nga shitja Kryerja e procedurave analitike të koston së riparimit dhe mirëmbajtjes për të identifikuar ndryshimet e pazakonta në trendet e shpenzimeve. Inspektimi i shtesave në pasuritë joqarkulluese për të identifikuar ndonjë shumë që është dashur të shpenzohet si kosto e riparimit. Inspektimi i një mostre të sistemit për të vërtetuar se i takojnë kostove të mirëmbajtjes së sistemit Dokumentoni sistemin e pagave, duke nënvizuar kontrollet përkatëse. Testomni

po ashtu është i ri. Sistemi mund të jetë i ndjeshëm ndaj gabimeve në dizjan të sistemit. Ka rrezik të anomalisë së kostove të pagave dhe detyrimeve përkatëse.

operimin e sistemit dhe kontrolleve përmec testeve hap-pas-hapi. Testoni një mostër të pagave duke i krahasuar me shifrat e futura në sistem dhe dokumentet mbështetëse. Krahasoni pagat dhe detyrimet e tatimit në paga me listën e pagave dhe librin e parasë.

(b) Procedurat e pavarura:

Për të konfirmuar saktësinë e shpenzimit të pagave auditori duhet të kryejë procedurat në vijim:

- Përputhja e shpenzimit të pagave nga sistemi i pagave me bilancin vërtetues të detajuar, hetoni ndryshimet.
- Mbledhni një mostër të pagave për të konfirmuar plotësinë dhe saktësinë e shpenzimit të pagave.
- Për një mostër të punonjësve, rillogaritni pagën neto dhe përputhni me regjistrat e pagave për të verifikuar saktësinë.
- Ri kryeni llogaritjet e tatimi të mbajtur dhe zbritjeve tjera nga pagat
- Krahasoni shpenzimin total të pagave me vitin e kaluar dhe hetoni çfardo ndryshimi domethënës.
- Rishikoni shpenzimet e pagave, krahasoni me buxhetin dhe diskutoni variancat domethënëse.
- Përzgjidhni një mostër të personave që janë punësuar dhe atyre që janë larguar për të verifikuar dokumentet mbështetëse, rillogaritni pagat nëse janë bërë di duhet.
- Për pagat, përputhni pagën neto sipas regjistrit të pagave me transferet nga banka dhe libri i parasë.

(c) Rrotacioni në auditim

Rrotacioni është term që përdoret për të limituar numrin e viteve që një individ ose firmë e auditimit është i shoqëruar me një klient të caktuar. Etika profesionale rekomandon që stafi i auditimit nuk duhet të shoqërohet një periudhë të gjatë me klientët. Edhe pse ofrimi i gjatë i shërbimeve të auditimit mund të konsiderohet si përparësi në njohjen e biznesit të klientit, kjo megjithatë nuk e tejkalon humbjen e skepticizimit profesional në rastin e shoqërimit të gjatë me klientin. Argumenti kundër rrotacionit është se firma shpenzon kosto shtesë dhe rrezik për shkak të mmosnjohurisë së duhur të klientit. Rrotacioni i auditorëve shpeks kërkohet me ligj në vende të ndryshme përveç kërkesës nga Kodi i Etikës.

Detyra 2

Ju jeni junior i auditimit në Alba-Audit, një firmë e licencuar e auditimit dhe ju kanë angazhuar në fushën e auditimit të pronës, impianteve dhe pajisjeve të Aqua Shpk, një kompani që prodhon dhe mbushë ujë me shije të ndryshme. Uji i shitet kompanive tregtare, restoraneve dhe hoteleve. Juve ju kanë ofruar tabelën në vijim në të cilën përmbledhen lëvizjet në pasuritë joqarkulluese për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2016.

	Toka dhe ndërtesa €000	Makineria dhe pajisjet €000	Total €000
Kosto 1 Janar 2016	1,867	3,641	5,508
Shtesat	1,212	706	1,918
Shitjet	-	(72)	(72)
Me 31 Dhjetor 2016	3,079	4,275	7,354
Zhvlerësimi			
Me 1 Janar 2016	510	1,645	2,155
Shpenzimi i vitit	39	435	474
Shitjet	-	(51)	(51)
Me 31 Dhjetor 2016	549	2,029	2,578
Vlera neto në libra			
Me 1 Janar 2016	1,357	1,996	3,353
Me 31 Dhjetor 2016	2,530	2,246	4,776

Në diskutimet e fundit me drejtorin financiar, ju keni konfirmuar se kompania përgatit buxhetin vjetor për shpenzime kapitale. Menaxherët e departamenteve mund të autorizojnë shpenzime kapitale deri në €5,000 për deri sa është brenda buxhetit. Ndërsa për shpenzimet kapitale që tejkalojnë €5,000 kërkohet aprovimi i bordit. Mirëpo, drejtori menaxhues i cili po ashtu është edhe aksionari më i madh i kompanisë, nuk e respekton gjithmonë këtë politikë. Ai shpesh vendos të blejë pasuri kapitale duke mos konsideruar se si do të financohen ato duke ia lënë kështu drejtorit financiar të arranzhoj huatë ose kreditë për ato blerje. Para secilës blerje kapitale kërkohen të plotësohen format e propozimit të blerjes, por kjo nuk bëhet gjithmonë sidomos në rastet kur kërkohet blerja urgjente e ndonjë artikulli. Gjithashtu kompania nuk ka politikë të grumbullimit të ofertave për artikuj domethënës kapital. Kompania ka regjistrin e pasurive joqarkulluese i cili harmonizohet me librin kryesor në baza mujore. Nuk ka ndonjë procedurë tjetër të kontrollit lidhur me regjistrin e pasurive joqarkulluese.

Kërkohet:

(a) Diskutoni mangësitë domethënëse në sistemin e kontrollit të pasurive joqarkulluese në kompaninë Aqua. Diskutimi juaj duhet të përfshijë implikimin e secilës mangësi dhe rekomandimin për të adresuar secilën. (10 pikë)

(b) Përshkruani PESË procedura të pavarura të cilat auditori zakonisht do t'i kryente në auditimin e pasurive joqarkulluese të Aqua dhe shpjegoni qëllimin e secilës procedurë. (10 pikë)

Total: 20 Pikë

Zgjidhja

Mangësia	Implikimi	Rekomandimi
Drejtori me anashkalon kontrollet e autorizimit. Kjo mangësi inkurajon shkeljen e sistemit të kontrollit.	Kjo ndikon në mundësinë për mashtrime dhe blerje jo të duhur të arkujve capital	Duhet të ketë një system formal të autorizimit për të gjitha transaksionet (psh dy drejtor duhet të autorizojnë të gjitha blerjet kapitale mbi 5,000 Euro. Gjoha strikte duhet të vendosen për rata që i shkelin këto kontrolle.
Nuk plotësohet gjithmonë format e propozimit për blerje. Mund të blihen pasuri që nuk janë të nevojshme ose jo të përshtatshme	Blerja e pasurive është shpenzim i madh. Çfardo shpenzimi i panevojshëm mund të rezultojë me mungesë të parasë, zvogëlim të fitimit dhe në fund në paaftësinë e kompanisë për të përmbushur detyrimet.	Duhet të plotësohen format e porosisë me kohë dhe duhet të aprovohen nga niveli i duhur i autoritetit.
Drejtori financiar nuk konsultohet para blerjes së pasurive. Presioni mbi drejtorin financiar mund të çojë në marrjen e ndonjë kredie të pafavorshme.	Interesat e lartë mund të shkaktojnë problem me rrjedhën e parasë dhe profitabilitetin. Mund të shkelen kushtet e kredive dhe në këtë mënyrë tërheqja e kredive nga banka.	Drejtorit financiar duhet ti ofrohet mundësia për të hetuar opsionet e financimit. Bordi duhet të diskutojë opsionin dhe të vendosë mënyrën e duhur të veprimit gjatë takimit të bordit.
Nuk ka politikë formale të marrjes së ofertave lidhur me blerjet kapitale. Pasuritë mund të blihen me kushte të pafavorshme dhe me cilësi të dobët.	Fitimet e kompanisë mund të ndikohen në mënyrë të kundërt pasi që mund të ndodhin kosto shtesë në riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre.	Në minimum duhet të merren tre oferta nga zyrtari i blerjes. Opsionet duhet të diskutohen dhe të pajtohen nga bordi.
Nuk ka ndonjë kontroll fizik mbi pasuritë dhe listën e pasurive. Pasuritë të cilat janë hequr nga regjistri nuk mund të identifikohen. Po ashtu pasuritë të cilat duhet të shlyhen nuk mund të identifikohen. Rrezik i rritur i vjedhjes.	Pasuritë të cilat vjedhen duhet të zëvendësohen që është kosto shtesë për kompaninë. Pasuria dhe fitimi i kompanisë do të mbivlerësohen	Duhet të ketë një procedurë të inspektimit formal së paku një herë në vit që të sigurohet se pasuria në listë ekziston fizikisht dhe pasuria fizike është në regjistër

b)

Procedura	Arsyeja
Përzgjedhni një mostër të pasurive nga regjistri i pasurive dhe inspektoni fizikisht.	Inspektimi i pasurive ofron dëshmi se pasuritë e regjistruara ekzistojnë dhe identifikon ndonjë dëmtim të mundshëm që mund të çojë në nevojën për zvogëlimin e vlerës së pasurisë.
Përzgjedh një mostër të pasurive fizike në përdorim dhe inspektoni regjistrin e pasurive joqarkulluese për të siguruar se janë regjistruar	Kjo ofron dëshmi lidhur me plotësinë e regjistrit të pasurive joqarkulluese.
Përzgjedh një mostër të pasurive joqarkulluese dhe rillogaritni zhvlerësimin për vitin	Kjo ndihmon në konfirmimin e saktësisë së shpenzimit të zhvlerësimit të regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe nëse janë përdorur politika të duhura të zhvlerësimit
Për një mostër të pasurive të blera gjatë vitit inspektoni faturat e blerjes për të konfirmuar koston e regjistruar në libra	Kjo ofron dëshmi lidhur me saktësinë e pasurive joqarkulluese dhe vlerësimin e pasurive në fund të vitit
Kryeni veprimet matematikore në kosto, zhvlerësim të akumuluar dhe vlerë neto në libra nga të dhënat nga kontabiliteti	Kjo ofron dëshmi për saktësinë numerike të librave prandaj edhe të vlerësimit të pasurive
Për një mostër të pasurive konfirmoni pronësinë përmes dokumenteve mbështetëse	Kjo konfirmon se kompania ka të drejta ligjore mbi pasuritë dhe verifikon të drejtat dhe obligimet
Inspektoni shënimin e pasqyrave financiare për pasuritë joqarkulluese. Përputhni saldoto fillestare dhe ato përfundimtare dhe me bilancin vërtetues.	Kjo ofron dëshmi se saldoto e pasurisë janë shpalosur si duhet në fund të vitit

Detyra 3

Likana SHA është një shitës me pakicë e mobiljeve e cila ka 500 dyqane në 20 shtete. Edhe pse kompania është ende profitabile, ajo është duke u ballafaquar me rënie të shitjeve në dy vitet e fundit, kryesisht për shkak të krizës ekonomike. Konkurrenca në sektorin e mobiljeve është rritur përmes ofrimit të zbritjeve domethënëse që kompanitë i ofrojnë konsumatorëve. Përveç programit të rinovimit prej €20 milion që kompania ka investuar në dyqanet e saj, Likana tash së voni ka investuar €1.5 milion në platformën e shitjes online. Këto investime janë financuar nga kredia bankare. Kjo ka mundësuar që kompania të jetë më konkurruese duke zvoëgluar çmimet për një numër të produkteve. Konkurrenca më e afërt e kompanisë tashmë ka një prezencë të dukshme online në vitet e fundit. Kompania së voni është qortuar nga rregullatori i standardeve të reklamimit lidhur me pretendimet e bëra për vijat e prodhimit të punuara nga 'druri i

qëndrueshëm'. Si rezultat i kësaj çështjeje, dizajneri kryesor i produkteve të kompanisë është larguar nga puna. Likana nuk ka plane për të mbyllur ndonjërin nga dyqanet dhe shpenzimet e qirasë së dyqaneve janë njëra nga kostot më të mëdha të kompanisë. Dy nga huadhënësit kryesor të kompanisë kanë filluar të shqetësohen lidhur me aftësinë e kompanisë për të pagur kreditë dhe janë duke konsideruar tërheqjen e kredive. Drejtorët e kompanisë besojnë se kompania ka një të ardhme të ndritshme afatgjatë bazuar në profitabilitetin dhe në shifrat shpresëdhënëse nga shitjet online. Auditorët janë informuar se drejtorët e Likana kanë arranzhuar një numër të takimeve me huadhënësit e tyre për të diskutuar mundësinë e ristrukturimit të kredive të tyre. Këto takime do të mbahen pasi që auditori të përfundoj raportin e auditimit.

Kërkohe:

(a) Përshkruani përgjegjësinë e auditorit lidhur me hipotezën e vijimësisë.

(2 pikë)

(b) Vlerësoni çfardo treguesi të mundshëm që Likana mund të ketë problem me hipotezën e vijimësisë dhe vlerësoni ndikimin e tyre të mundshëm në afësinë e kompanisë për të vijuar tregëtimin. (8 pikë)

(c) Rekomandoni procedurat e auditimit që auditori i Likana duhet të kryej në vlerëimin nëse kompania është duke operuar sipas hipotezës së vijimësisë. (6 pikë)

(d) Përshkruani ndikimin në raportin e auditimit nëse auditorët besojnë se ekziston një pasiguri materiale lidhur me hipotezën e vijimësisë së Likana. (4 pikë)

Total: 20 Pikë

Zgjidhja

(a)

Përgjegjësia e auditorit për vijimësinë

Përgjegjësia e auditorit është të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit lidhur me përshatshmërinë e hipotezës së vijimësisë të përdorur nga menaxhmenti gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare. Auditori duhet të vlerësojë vlerësimin e bërë nga menaxhmenti lidhur me aftësinë e kompanisë për të vijuar ekzistencën dhe nëse ka ndonjë pasiguri materiale që mund të hedh dyshim mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar e cila do të duhej të shpalosej në pasqyra financiare. Nëse identifikohen kushte ose ngjarje të cilat hedhin dyshim mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar operacionet, auditori duhet të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të përcaktuar nëse ekziston një pasiguri materiale përmes kryerjes së procedurave shtesë të auditimit përfshirë ato që janë specifikuar në SNA 570.

Treguesit e hipotezës së vijimësisë

Treguesi	Pse mund të ndikojë në hipotezën e vijimësisë
Kompania është duke u ballafaquar me rënie të shitjeve në dy vitet e fundit.	Rënia e shitjeve do të thotë se kompania mund të ketë vështirësi në gjenerimin e rrjedhës së parasë për të mbuluar kostot.
Konkurrenca është rritur, e karakterizuar me 'çmime të zbritura' në mënyrë domethënëse.	Konsumatorët mund të ikin tek konkurrenca për shkak të çmimeve me zbritje ose kompania mund të zbres vetë çmimet deri në atë masë sa të mos jetë në gjendje të gjeneroj fitim ose rrjedhë të parasë së mjaftueshme.
Kompania ka investuar në një platform online për tregtinë elektronike.	Ekziston rreziku se platforma e re 'dështon' dhe kështu konsumatorët mund të kenë problem në blerje. Investimi mund të dështoj në mbulimin e kostove e që mund të rritë presionin financiar në kompani.
Investimet domethënëse janë financuar përmes kredive të reja nga banka.	Kosto të larta të financimit rrisin rrezikun që kompania të mos jetë në gjendje të gjenerojë para të mjaftueshme për të mbuluar koston e interesit. Ka rrezik se mund të shkelen kushtet e kredisë që mund të rezultojn me tërheqjen e kredisë në bankat.
Kompania është qortuar pas shkeljeve të standardeve të reklamimit.	Kjo mund të rezultojë me publicitet negativ dhe mungesë të besimit nga konsumatorët. Kjo pastaj mund të ndikojë në rënie të shitjeve por gjithashtu edhe në gjoha tjera që mund të ndikojë në hipotezën e vijimësisë.
Dizajneri senior është larguar nga kompania.	Humbja e personelit kyç do të thotë se kompania mund të mos jetë në gjendje të dizajnojë dhe prodhojë produkte që duan konsumatorët. Kjo mund të rezultojë në rënie të shitjeve dhe rrjedhës së parasë dhe të çojë në probleme me hipotezën e vijimësisë.
Shpenzimet e qirasë si kosto fikse, përbëjnë një pjesë domethënëse të shpenzimeve të kompanisë.	Rënia e shitjeve do të thotë se kompania mund ta ketë të vështirë të mbulojë kostot fikse. Është rrezik i madh që kompania mund të dështojë të paguaj borxhet me kohë.

Dy huadhënës janë duke konsideruar të tërheqin kreditë e tyre.	Kompania ka pak gjasa të vazhdojë tregtimin pa kredi. Huadhënësit mund të detyrojnë kompaninë në likuidim.
--	--

(c)

Procedurat e auditimit që auditori i kompanisë duhet t'i kryejë për të vlerësuar nëse kompania është e aftë të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë janë të listuara më poshtë:

- Përftoni dhe rishikoni parashikimet e rrjedhës së parasë dhe vlerësoni nëse është përfshirë ndikimi i rënies së shitjeve. Vlerësoni supozimet e bëra lidhur me shitjet e parashikuara nga sistemi online.
- Rishikoni pasqyrat menaxheriale pas fundit të vitit për dëshmi në rënie të performancës. Kjo mund të përfshijë ekzaminimin nëse kompania është në gjendje të mbulojë kostot e financimit.
- Rishikoni të dhënat për shitjet pas fundit të vitit lidhur me shitjet online për të përcaktuar nëse besimi i drejtorëve është i arsyeshëm.
- Diskutoni me menaxhmentin nëse kanë identifikuar ndonjë burim alternative të financimit në rast të tërheqjes së kredive nga bankat.
- Diskutoni me drejtorët cilat janë planet e tyre lidhur me zbritjet e çmimeve të ofruara nga konkurrenca.
- Ekzaminoni korrespondencat me avokatët dhe autoritetet rregullatore për të identifikuar nëse mund të ketë gjopa të mëtutjeshme kundrejt kompanisë.
- Rishikoni procesverbalet e taikimit të bordit për të identifikuar cilat janë planet e kompanisë lidhur me publicitetin negativ.
- Rishikoni korrespondencat me bankat për të përcaktuar nëse kompania ka shkelur ndonjë kusht nga bankat dhe që mund të ndikojë në vazhdimin e kredisë ose overdrafteve.
- Diskutoni me drejtorët cilat janë planet e tyre për publicitetin negativ nga shkelja e standardeve të reklamimit.
- Diskutoni me drejtorët nëse planifikojnë të zëvendësojnë dizajnerin e produkteve dhe vlerësoni se deri ku kanë shkuar planet për punësimin e personit të ardhshëm.

(d)

Pasiguria lidhur me përtëritjen dhe ristrukturimin e kredisë është një çështje e një rëndësie fundamentale, e cila duhet të sjellet në vëmendjen e aksionarëve.

Do të duhej të përfshihet një paragraf i theksimit të çështjes në raportin e auditimit.

Ky paragraf duhet të përfshihet pas paragrafit të opinionit dhe do të shpjegonte pasigurinë lidhur me hipotezën e vijimësisë dh do t'i referohej një shënimi në pasqyrat financiare ku janë paraqitur informatat e detajuara.

Opinionin e auditimit nuk do të ndryshonte, do të mbetet i pamodifikuar. Nëse megjithatë drejtorët do të dështonin të përfshinin një shënim në pasqyra financiare, auditori do të kualifikonte (rezervonte) opinionin me 'përveç për' për shkak të anomalisë materiale. Pasqyrat financiare do të përmbanin anomali për shkak të mos-shpalosjes së një pasigurie.

Detyra 4

Pa marrë parasysh nëse auditori është duke audituar një biznes të vogël ose kompani multinacionale, ai/ajo duhet të vlerësojë informatat financiare që procesohen ose ruhen në një sistem të kompjuterizuar.

Kërkohe:

Lidhur me auditimin në një mjedis të sistemit të informatave financiare:

- (a) Bëni dallimin në mes të kontrolleve të përgjithshme dhe kontrolleve të aplikimeve. (4 pikë)
- (b) Cilat janë përfitimet e përdorimit të Teknikave të Auditimit të Ndihmuara nga Kompjuteërt (TANK)? (3 pikë)
- (c) Përshkruani tre faktorë që një auditor duhet të konsideroj kur auditon një kompani që është e përfshirë në tregëti elektronike. (3 pikë)
- (d) Kebo Shpk është klient i firmës tuaj. Jeni duke i rishikuar planet për auditimin e numërimit fizik të stoqeve në depon e kompanisë me 31 dhjetor 2016. Kompani monton pajisje elektrike të kuzhinës. Stoqet e pajisjeve të përfunduara, të pjesëve të pamontuara dhe stoqeve tjera mbahen në depo që është ngjitur me fabrikën e montimit. Fabrika do të vazhdojë të prodhoj produkte gjatë numërimit të stoqeve deri në orën 17:00 me 31 dhjetor 2016. Me 30 dhjetor 2016, personeli i depos do të dërgojë sasi të përafërta të pjesëve të pamontuara dhe stoqeve tjera që do të nevojiten për prodhimin e datës 31 dhjetor 2016. Mirëpo, kërkesat për artikuj emergjent do të plotësohen me 31 dhjetor. Gjatë numërimit të stoqeve, personeli i depos do të vazhdojë të pranojë pjesë dhe stoqe tjera dhe të dërgojë produkte të gatshme. Pajisjet që kanë përfunduar me 31 dhjetor 2016 do të mbesin në fabrikën e montimit deri pas përfundimit të numërimit fizik të stoqeve.

Kërkohe:

Rekomandoni procedurat të cilat Kebo Shpk duhet t'i zbatojë në mënyrë që të siguroj se të gjitha stoqet janë numëruar dhe asnjë artikull nuk është numëruar dy herë. (10 pikë)

Total: 20 Pikë

Zgjidhja

(a) Kontrollat e përgjithshme

Këto janë kontrollet e përgjithshme të cilat mbulojnë mjedisin në të cilin operojnë sistemet e kompjuterizuara. Në përgjithësi, kjo kategori mbulon kontrollet organizative, kontrollet mbi zhvillimet e sistemeve dhe mirëmbajtjes, kontrollet e qasjes dhe kontrolle tjera.

Kontrollet e aplikacioneve

Këto janë kontrolle të cilat përqipen të sigurojnë saktësinë dhe plotësinë e procesimit të inputeve, kontrolleve të procesimit dhe kontrolleve të outputeve. Këto kontrolle të aplikacioneve janë të dizajnuara për të zbuluar gabimet para, gjatë dhe pas procesimit.

(b) Disa nga përfitimet e përdorimit të TANK janë:

- Aftësinë për të testuar tërë popullatën ose një pjesë më të madhe të popullatës se sa përdorimi i mostrës
- Mund të dizajnohen dhe programohen teste të zakonshme në mënyrë që të përsëriten disa herë dhe kështu të rrisin efikasitetin e auditimit
- Përdorimi i të dhënave për analizë në mënyrë që të dhënat që janë importuar në sistemet e testimit nuk mund të ndryshohen dhe kështu të zvogëlohet rreziku i ndryshimeve aksidentale të të dhënave

(c) Kur auditohen kompanitë që janë të përfshira në tregtinë elektronike ka disa faktorë që duhet të konsiderohen nga auditorët:

- Komplexiteti – në një mejdis online ka shumë mundësi që transaksionet të jenë më komplekse se në një biznes historic. Auditori duhet të jetë i vetdijshëm se e kupton rrjedhën e transaksioneve dhe rreziqe të kontrollet përkatëse.
- Vëllimi – për shumicën e bizneseve online, vëllimi i transaksioneve mund të jetë shumë i lartë. Kjo mund të kërkojë përdorimin e TANK për të mundësuar mbulimin e tërë popullatave.
- Shpejtësia e transaksionit – përveç vëllimit të madh të transaksioneve, në një mjedis online transaksionet kanë tendencë të bëhen shumë shpejtë. Kjo do të thotë se shpesh ka mungesë të kontrolleve manual prandaj auditori duhet të sigurohet se entiteti ka kontrolle automatike të mjaftueshme në të cilat mund të mbështetet.
- Siguria – në një mejdis online kërkohet që informatat të jenë të sigurta pasi që shumë biznese grumbullojnë të dhëna të ndjeshme dhe personale të konsumatorëve. Rrjedhja e këtyre informatave mund të shkaktojë probleme të mëdha për biznesin.

(d) Procedurat që kompania mund të adoptojë për të siguruar se stoqet numërohen saktësisht:

1. Personi zyrtar ka kontrollin e përgjithshëm mbi numërimin, të gjitha pyetjet dhe problemet duhet të adresohen te ai.
2. Stoqet duhet të mbahen si duhet dhe secili artikull i stoqeve duhet të shenjohe kur numërohet. Në fund të numërimit duhet të kontrollohet nëse tërë stoqet kanë shenja.
3. Fletët e numërimit duhet të përgatiten nga kompania për të identifikuar stoqet që duhet numëruar.
4. Ekipet e numërimit duhet të shpërndahen në lokacionet specifike, dhe stoqet duhet të numërohen nga ekipet në një formë të paracaktuar.
5. Lëvizja e stoqeve duhet të mbahet në minimum. Në rast të ndonjë lëvizje emergjente të stoqeve duhet të regjistrohen ato stoqe dhe të rishikohen nga personi përgjegjës. Duhet të sigurohet se këto stoqe janë përjashtuar nga stoqet e pjesëve të pamontuara.
6. Kompania duhet të sigurojë se të gjitha stoqet e pranura gjatë ditës së numërimit janë të ndara dhe numërohen vetëm atëherë kur nuk pritet të pranohen mallra tjera.
7. Mallrat të cilat do të dërgohen gjatë ditës së numërimit duhet të mbahen ndaras dhe të mos përfshihen në stoqet përfundimtare. Mënyra më e mirë është të regjistrohen këto stoqe në një fletë të veçantë.

8. Pasi qe pajisjet e përfunduara me 31 dhjetor do të mbesin në fabrikën e montimit dhe e vetmja lëvizje e stoqeve do të jenë stoqet e emergjencës, fabrika e mosntimit mund të trajtohet si njësi e veçantë gjatë numërimit. Prandaj mënyra më e mirë për të siguruar saktësinë e stoqeve në fabrikën e montimit është të pritët deri në ora 17:00 për të filluar me numërimin.

Detyra 5

(a) Shpjegoni çështjet që duhet të konsiderohen nga auditori para se të vendos për llojin e modifikimit të raportit të auditimit nëse kërkohet. **(5 pikë)**

(b) Firma juaj sapo ka përfunduar auditimin e klientit Artana Shpk për vitin që përfundon 31 dhjetor 2016 dhe më poshtë është lista e çështjeve që janë përgatitur për tu konsideruar nga ju.

(i) Me 5 shkurt 2017, Artana është pajtuar të paguaj një shtesë në paga prej 5% për të gjithë të punësuarit duke përdorur datën e mëparshme me 1 tetor 2016. Nuk është bërë ndonjë provizion për këtë shpenzim në pasqyrat financiare. **(5 pikë)**

(ii) Deklarata draft e kryesuesit të bordit që do të përfshihet në Raportin vjetor të kompanisë, thekson se fitimet janë rritur për 23%. Është e vërtetë se fitimi operativ është rritur për 23% por, pas zbritjes së kostove të riorganizimit dhe humbjeve nga shitja e pasurive joqarkulluese, fitimi nga aktivitetet, para dhe pas tatimit është rritur vetëm për 3% krahasuar me vitin e mëparshëm. **(5 pikë)**

(iii) Auditim ka zbuluar një mangësi domethënëse në menaxhimin e investimeve. Kompania tash së voni ka punësuar një menaxher financiar për të menaxhuar investimet nga fondet tepricë të kompanisë. Politika e kompanisë është të investojë në aksione të kompanive të mëdha të listuara në bursa. Auditimi ka zbuluar disa raste ku menaxheri financiar ka krijuar fitime domethënëse për kompaninë duke spekuluar në investime me rrezik të madh siç janë kontratat derivative. Investimet e tilla mund të rezultojnë me humbje shumë të mëdha. Kjo çështje ishte raportuar te drejtori financiar katër muaj më parë por ende nuk është ndërmarrë asnjë veprim. **(5 pikë)**

Supozoni se secila nga këto çështje është materiale dhe duhet të konsiderohet në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra.

Kërkohet:

Konsideroni cilat veprime të mëtutjeshme duhet të ndërmarrë firma juaj lidhur me tre çështjet e listuara më sipër në (b) (i) deri (iii).

Total: 20 Pikë

Zgjidhja

(a) Në vendimin se çfarë lloji i modifikimit nevojitet, auditori duhet të merr parasysh:

- Pasigurinë e çështjes për të cilin kërkohet modifikimi.
- Mundësia e ndodhjes së gabimit.
- Ekspertiza e auditorit dhe dëshmitë e përdorura ose nevoja për dëshmi shtesë për të arritur një konkluzion
- Diskutimi me menaxhmentin / personat e ngarkuar me qeverisjen lidhur me çështjen
- Sa është përhapës ndikimi i çështjes në pasqyrat financiare
- Rëndësia e vetëvetishme e çështjes dhe materialiteti i saj

(b) (i) Ngjarje pasuese

Marrëveshja për të paguar me datë prapa është një ngjarje që kërkon korrigjim pasi që ka të bëjë me periudhën e mëparshme edhe pse niveli i pagesës nuk është i ditur në fund të vitit. Ju duhet të konfirmoni rritjen e pagave me marrëveshm, kontrolloni llogaritjet e shumave që janë mbetur borxh dhe të vlerësoni materialitetin dhe efektin në fitim. Auditorët duhet të rekomandojnë drejtorëve që të njihet një detyrim me 31 dhjetor dhe të korrigjohet llogaria e shpenzimeve. Nëse drejtorët nuk pranojnë të korrigjojnë pasqyrat financiare dhe pasi që shuma është materiale atëherë kjo përbën anomali materiale në pasqyra dhe ndikon në modifikimin e opinionit.

(ii) Informatat tjera

Deklarata e kryesuesit duket se paraqet një jokonsistencë materiale me pasqyrat financiare të audituara në pajtueshmëri me SNA 720. Deklarata sugjeron se fitimi operativ përfaqëson nivelin e vërtetë të performancës. Mirëpo SNK 1 Paraqitja e Pasqyrve Financiare kërkon që zërat siç janë kosto të riorganizimit dhe fitimet dhe humbjet nga shitja e pasurive të përfshihen në llogaritjen e fitimit të periudhës. Auditori duhet të këshillojë kryesuesin që të korrigjojë deklaratën për të shmangur jokonsistencën me pasqyrat financiare. Nëse kryesuesi refuzon të bëjë këtë, auditori ka mundësi të përfshijë një paragraf të theksimit të çështjes pas opinionit pa rezervë. Nëse çështja bëhet më serioze auditori mund të refuzoj dhënien e opinionit, të tërhiqë nga angazhimi dhe të kërkojë këshilla ligjore.

(iii) Kontrolli i brendshëm

Edhe pse këshillimi i klientëve të auditimit për mangësitë e kontroleve nuk është objektivi kryesor i auditorëve të jashtëm, shumë juridiksione i kanë fajësuar auditorët e jashtëm për neglizhencë për mos komunikimin e duhur të mangësive me personat e ngarkuar me qeverisjen. Është e njohur se një tregtim i tillë i rrezikshëm mund të jetë i madh dhe me pasoja të mëdha. Auditorët pasi që kanë mësuar faktin se drejtori financiar nuk ka ndërmarr hapa të duhura, atëherë këtë çështje duhet ta ngrisin në nivelin më të lartë siç është bordi i drejtorve ose komiteti i auditimit, nëse ekziston.